



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 574/1 prot.

Tiranë, më 29.06.2020

VENDIM
Nr.46, datë 29.06.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 115, DATË 05.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA DROPULL

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 115, datë 05.11.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Dropull, në bazë të urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Dropull.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Dropull, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 115, datë 05.11.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Dropull, me shkresën nr.2032/1 prot., datë 14.01.202 dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike me e-mail të datës 9 dhe 10 qershor 2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Dropull, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Institucioni ka marrë masa dhe ka rikthyer gjendjen e ligjshmërisë për 5 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, më konkretisht për: *****, *****, *****, *****, duke u vendosur ndërprerja e marrdhënies së punës.
2. Njësia përgjegjëse ka realizuar procedurat e konkurrimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
3. Institucioni i mbikëqyrur, me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2020, ka miratuar planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2020.
4. Bashkia Dropull funksionon në përputhje me strukturën e miratuar me Urdhrin nr.3, datë 06.01.2020 dhe, në zbatim të orientimeve të lëna në vendimin paralajmërues, janë evidentuar qartazi pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativë*).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 115, datë 05.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Dropull, në bazë të urdhrit nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Dropull.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Dropull.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha